

URDHËR
Nr. 203, datë 18.10.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN E MINISTRIT TË
BRENDSHËM NR. 367, DATË 18.11.2021, “PËR PËRBËRJEN, DETYRAT DHE
MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE PËR PAJISJEN E SUBJEKTEVE
ME LICENCË/AUTORIZIM PËR VEPRIMTARINË E LEJUAR ME ARMË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe pikës 2, të nenit 36, të ligjit nr. 74, datë 10.7.2014, “Për armët”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin e ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I të urdhrin bëhen këto ndryshime:

a) pika 1, e kreut I, të urdhrin, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“1. Ngritjen e Komisionit Qendror për dhënien e licencave/autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armët (KSHKLA) në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me këtë përbërje:

- a) drejtori i Departamentit për Sigurinë Publike – kryetar;*
- b) drejtori i Drejtorisë së Rendit Publik – anëtar;*
- c) drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda – anëtar;*
- ç) shefi i Sektorit të Shërbimeve ndaj të Tretëve – anëtar;*
- d) përgjegjës sektori i Ndihmës Juridike – anëtar;*
- dh) shefi i Sektorit të Armatimit dhe Pajisjeve Speciale – anëtar;*
- e) specialist i Sektorit të Shërbimit ndaj të Tretëve – anëtar”;*

b) pika 5, e kreut I, të urdhrin, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“5. Komisioni pranon dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga strukturat vendore të policisë dhe subjekte të tjera, sipas aplikimeve të kryera online, duke kryer procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të veprimtarisë së subjektit, përgatit mendimin paraprak dhe ia propozon për miratim drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”

2. Në kreun II të urdhrin bëhen këto ndryshime:

a) pika 1, e kreut II, të urdhrin, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“1. Ngritjen e Komisioneve Vendore për dhënien e autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armët në drejtoritë vendore të Policisë, me këtë përbërje:

Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë:

- a) zëvendësdrejtori për Sigurinë Publike – kryetar;*
- b) shefi i Sektorit për Krimet në Volum – anëtar;*
- c) specialist për Arkivën Kriminale – anëtar;*
- ç) specialist për Armët dhe Lëndët Plasëse – anëtar;*
- d) specialist në Seksionin Juridik – anëtar;*

Në drejtoritë e tjera vendore të Policisë:

- a) zëvendësdrejtori për Sigurinë Publike – kryetar;*
- b) shefi i Sektorit për Krimet në Volum – anëtar;*
- c) specialist për Arkivën Kriminale – anëtar;*
- ç) specialist për Shërbimin ndaj të Tretëve – anëtar;*
- d) specialist jurist – anëtar”;*

b) në pikën 2, pas shkronjës “a” të kreut II të urdhrit, shtohet shkronja “a/i”, me këtë përmbajtje:
“a/i) pezullim/shfuqizim të autorizimit për mbajtje arme zjarri të kategorisë “B” dhe municioneve përkatëse”

c) pika 5, e kreut II, të urdhrit, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“5. Komisioni pranon dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga struktura përkatëse në Drejtorinë Vendore të Policisë, sipas aplikimeve të kryera online nga qytetarët, duke kryer procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të veprimtarisë së subjektit, përgatit mendimin paraprak dhe ia propozon për miratim drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë.”;

ç) pika 7, e kreut II, të urdhrit, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“7. Autorizimi përgatitet në dy kopje, ku njëra dërgohet në Zyrën e Shërbimit për Qytetarët, për t’ia përcjellë online qytetarit dhe përfunduar procedurën e shërbimit të kërkuar, ndërsa një kopje administrohet në sekretari/arkiv të Drejtorisë Vendore të Policisë.”

d) pika 9, e kreut II, të urdhrit, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“9. Vendimi përfundimtar i Komisionit të Ankesave në Drejtorinë Vendore të Policisë, i komunikohet online ankuesit nëpërmjet Zyrës së Shërbimit për Qytetarët, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të Komisionit, duke i kthyer përgjigje të argumentuar dhe të bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.”

3. Në kreun III të urdhrit bëhen këto ndryshime:

a) pika 1, e kreut III, të urdhrit, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“1. Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) për marrjen në shqyrtim të ankesave ndaj akteve të refuzimit/pezullimit/shfuqizimit të licencës/autorizimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me këtë përbërje:

a) zëvendës drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit – kryetar;

b) drejtori i Drejtorisë së Standardeve Profesionale – anëtar;

c) drejtori i Drejtorisë Juridike – anëtar;

ç) shefi i Sektorit të Rendit Publik – anëtar;

d) specialist i Sektorit të Shërbimit ndaj të Tretëve – anëtar”;

b) pika 7, e kreut III, të urdhrit, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“7. Vendimi përfundimtar i miratuar nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, i komunikohet me shkresë dhe i përcillet online ankuesit nëpërmjet Zyrës së Shërbimit për Qytetarët, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit, duke i kthyer përgjigje të argumentuar dhe të bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, ndërsa një kopje administrohet në sekretari/arkiv të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”

4. Në kreun IV të urdhrit bëhen këto ndryshime:

a) pika 1, e kreut IV, të urdhrit, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“1. Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për marrjen në shqyrtim të ankesave ndaj akteve të refuzimit/pezullimit/shfuqizimit të autorizimit në drejtoritë vendore të Policisë, me këtë përbërje:

Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë:

a) zëvendës drejtori për hetimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda – kryetar;

b) shefi i Sektorit për Rendin Publik – anëtar;

c) shefi i Seksionit Juridik – anëtar;

ç) shef seksioni për Shërbimin ndaj të Tretëve – anëtar;

d) specialist për Shërbimin ndaj të Tretëve – anëtar;

Në drejtoritë e tjera vendore të Policisë:

a) zëvendës drejtori për hetimin e krimeve në DVP - Kryetar

b) shefi i Sektorit për Rendin Publik – anëtar;

c) shef seksioni Pol Komunitet dhe Shërbimin ndaj të Tretëve – anëtar;

ç) specialist për Shërbimin ndaj të Tretëve – anëtar;

d) specialist jurist – anëtar”;

b) pika 7, e kreut IV, të urdhrit, ndryshon dhe zëvendësohet, me përmbajtjen si më poshtë:

“7. Vendimi përfundimtar i miratuar nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, i komunikohet me shkresë dhe i përcillet online ankuesit nëpërmjet Zyrës së Shërbimit për Qytetarët, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit, duke i kthyer përgjigje të argumentuar dhe të bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, ndërsa një kopje administrohet në sekretari/arkiv të Drejtorisë Vendore të Policisë.”

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Ervin Hoxha